

Drejtuar:

Komisionit Recenzues në përbërje: Prof.Dr.Vullnet Ameti (Kryetar), Prof.Dr.Ajri Ziba (Anëtar) dhe Prof.Dr.Isa Asllani (Anëtar) të formuar në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike më datë 14.12.2017 (Nr. 19-397/1) dhe të Këshillit të Rektoratit të datës 24.01.2018 (Nr. 02-113/1) të Universitetit të Tetovës, lidhur me Konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore, të shpallur në Buletinin nr 128 të Universitetit të Tetovës të shpallur në web-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk (file:///D:/user/Downloads/buletin128.pdf) më datë 26.03.2018 dhe publik duke filluar nga 26.03.2018 deri më 09.04.2018.

Nga Prim.Dr.Sci.Med.Dr. Bajram Kamberi

ANKESË

Objekti i ankesës:

1.Referati për zgjedhjen/rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndën Kineziterapi në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës në bazë të pasqyrës (dokumentacioni i parashtruar nga ana e kandidatëve Metin Dalip dhe Bajram Kamberi) të prezantuar në Buletinin nr 128 të Universitetit të Tetovës të shpallur në web-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk (file:///D:/user/Downloads/buletin128.pdf) më datë 26.03.2018 si dhe të dhënat në Shtojcë të vlerësuar nga komisioni recenzues për raport recenzioni drejtuar Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës për lëndën Kineziterapi.

Disa tregues si bëhet vlerësimi:

1.Publikohet një rënditje jo adekuate në bazë të pikave: "PERFUNDIMI DHE PROPOZIMI Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lart si dhe nga të dhënat në Shtojcë, Komisioni Recenzues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore- arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati Prof. Dr. Metin Dalip në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimoreprofesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin të Tetovës (Buletini i Universitetit), ka tubuar gjithsej 192.016 pikë nga referencat profesionale dhe me këtë e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimoreshkencore Profesor Ordinar. Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni përfundon se Prof. Dr. Metin Dalip ka kualitet shkencor dhe profesional dhe sipas Ligjit për arsim të lartë si dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin të Tetovës i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në thirrjen që ka konkurruar."

2. "Në shtojcë është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Dr. Metin Dalip ka grumbulluar gjithsej 192.016 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimorearsimore 104.520 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese 46.496 pikë, veprimtarinë profesionaleaplikative 23 pikë dhe veprimtaritë me interes më të gjerë 18 pikë.", por në fakt kalkulimi i mësipërm në shtojcë është ndryshe për; veprimtarinë mësimorearsimore Gjithsej (I.1-14): 104.520 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese Gjithsej (II.1-II5): 46.496 pikë, veprimtarinë

profesionale aplikative Gjithsej (III.1-III.4): 13 pikë, dhe veprimtaritë me interes më të gjerë Gjithsej (IV.1-IV.5): 18.0 pikë; dhe gjithsej sipas shumës së përgjithshme del se kandidati Metin Dalip ka grumbulluar gjithsej 182.016 e jo gjithsej 192.016 pikë sipas "REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE".

3. Te kandidati Metin Dalip metodologjia e vlerësimit në veprimtaritë shkencore-hulumtuese nuk bazohet mbi baza të njëjta në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale të bashkëpunëtorit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës, për shembull me mbajtjen e ushtrimeve (lëndët në ciklin e parë të studimeve (I.2: Aerobik (0+2), 1 semestër $4 \times 15 \times 6 \times 0.03 = 10.80$) ..etj.

4. Për kandidatin Bajram Kamberi, shkruhet "Kandidati nuk ka dorëzuar dëshmi për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore të docentit apo profesorit inordinar. Veprimtaria shkencore-hulumtuese Dr. Sc. Bajram Kamberi ka dorëzuar listë të pjesëmarrjes në projekte, simpoziume shkencore e profesionale, si dhe listë të artikujve dhe publikimeve të botuara në revista të ndryshme në vend dhe jashtë." dhe në fund publikohet një rënditje jo adekuate në bazë të pikave që maten me një sistem pikëzimi të ndryshëm te kandidatët Metin Dalip dhe Bajram Kamberi.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme si dhe nga të dhënat tjera për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatëve që kanë konkuruar të prezantuar në Buletinin nr 128 të Universitetit të Tetovës të shpallur në web-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk (file:///D:/user/Downloads/buletin128.pdf) më datë 26.03.2018 kam nderin Komisionit Recenzues në përbërje: Prof.Dr.Vullnet Ameti (Kryetar), Prof.Dr.Ajri Ziba (Anëtar) dhe Prof.Dr.Isa Asllani (Anëtar) t'i propozojë RIVLERËSIM të fakteve rreth të cilave bëhet ankesa dhe të dhënave të tjera në Shtojcë të (jo)vlerësuar për raport recenzionin drejtuar Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës për lëndën Kineziterapi.

Me respekt!

Data: 06.04.2018

Ankuesi: Prim.Dr.Sci.Med.Dr. Bajram Kamberi


Dr.sci. med. Bajram H. Kamberi
Примариум, спец. по неврологија
Primarius, spec. për neurologji
724041